

**AKTI I THEMELIMIT**  
**TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Media Prospect” shpk**

**Neni 1 - Emri**

1.1 Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“Media Prospect”** më poshtë do të quhet **“Shoqëria”**.

**Neni 2 - Themelimi**

2.1 Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin Shqiptar, me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

**Neni 3 - Selia**

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Zona Kadastrale me nr. 8160, ne “Qytet Studenti”, rruga “Pjeter Budi”, objekt 3 kt, kati 2, njesia bashkiake nr.2, Tirane, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë.

**Neni 4 - Ortakët**

4.1 Ortaket e Shoqërisë janë:

- 1 - Z.Francesco Ranieri, i biri i Elia Ranieri dhe i Oriana Offidani, i dtl. 17.05.1985, lindur ne Civitanova Marche dhe banues në Treurenburgestraat 33, 5613 EA, Eindhoven, The Netherlands, mbajtës i kartes se identitetit me nr. AT 1554691, i cili zoteron 50% te kapitalit.
- 2 - Z.Paolo Rinaldesi, i biri i Enrico Rinaldesi dhe i Franca Marconi, i dtl. 10.04.1986, lindur ne Corridonia dhe banues në Lijmbeekstraat 188, 5612 NJ, Eindhoven, The Netherlands, mbajtës i kartes se identitetit me nr. AS 1468283, i cili zoteron 50% te kapitalit

**Neni 5 - Kapitali Themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ne vlerën 200,000 leke i ndarë në 2 pjesë, me vlerë nominale 100,000 Lekë. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer në tërësi nga ortakët themelues.


5.2 Kuotat, me vendim te Ortakëve, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës se shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër të parashikuar nga ligji.

**Neni 6 - Objekti**

6.1 Objekti i Shoqërisë është:

Sherbime publiciteti ne te gjitha format e transmetimit ne web, dhe te tjera si: e- mal, display, webradio, web tv, socialnetwork etj, si nga shoqeria por edhe si konsulent. Ndermjetesues marketing. Projektim, realizim dhe dergim te fushatave mail - marketing si nga vete shoqeria ose si konsulent. Projektim, realizim dhe dergim te





fushatave sms- marketing si nga vete shoqeria Projektim, realizim dhe dergim te fushatave social network-marketing si nga vete shoqeria ose si konsulent E-commerce si nga vete shoqeria ose si konsulent; Dizenjim, prodhim dhe marketing.

#### **Neni 7 - Kohëzgjatja**

7.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

#### **Neni 8 - Kompetencat e Ortakëve**

8.1 Ortakët, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri te tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

#### **Neni 9 - Administrimi i Shoqërisë**

9.1 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- Z. Ferat Mekshi, i biri i Ramadan dhe i Shyqyrie, i dtl. 17.05.1994, lindur ne Pishkash Verri, Librazhd dhe banues në Tirane, Zona Kadastrale me nr. 8160, ne "Qytet Studenti", rruga "Pjeter Budi", objekt 3 kt, kati 2, njesia bashkiake nr.2, Tirane, Shqipëri, mbajtës i pashaportes me nr. BG3634032 dhe nr. personal J405170140, lëshuar nga MB në dt. 17.10.2013.

9.2 Administratori emërohet me vendim të Ortakëve dhe do te qëndrojë në detyrë për një afat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Administratorët emërohen dhe shkarkohen nga detyra në çdo kohë me vendim të Ortakëve dhe/ose në përputhje me dispozitat ligjore.

#### **Neni 10 - Ligji i Zbatueshëm**

10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë aktivitetit të Shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes pranë Gjykatës kompetente të Rrethit Gjyqësor Tirane.

10.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe.

Nënshkruar sot më datë 19.09.2019, nga:

Ortakët

Z. Francesco Ranieri



Z. Paolo Rinaldesi

